



Rrok Prizren
Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren
Ismet J Kumanova, Nr. 31 – 20000/Prizren
www.rrok-pz.net & info@rrok-pz.net
+381-29-222-771

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Zyrtarizohet bashkëpunimi shoqëri civile – qeveri lokale për zhvillimin e turizmit kulturor

21 shtator 2012, Prizren

Sot në ndërtesën e Beledijes në Prizren u nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit mes Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Prizren dhe Drejtorisë komunale të Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik. Ky memorandum i bashkëpunimit nënshkruhet për ndërtimin e partneritetit strategjik dhe nisjen e dialogut të strukturuar në mes të Rrok-ut dhe DTZhe-së. Qëllimi i këtij partneriteti është që – përmes veprimit të përbashkët të partnerëve – të kontribuojë në rritjen e ekonomisë lokale të Prizrenit përmes potencialit kulturor dhe turistik.

Rrjeti i Organizatave të Kulturës – Rrok Prizren dhe Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, përmes memorandumit të nënshkruar sot, janë zotuar që bashkërisht të realizojnë këto aktivitete: Hartimi dhe zbatimi i politikave publike për zhvillimin e turizmit, Kalendarit kulturor dhe turistik i Prizrenit, Hulumtimi mbi kapacitetet dhe nevojat e sektorit të kulturës në Prizren, Paketë turistike dhe oferta të tjera turistike, Ndriçimi dhe shenjzimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, Stimulimi i zejeve në zhdukje e sipër, Hartimi i përbashkët i buxhetit komunal për sektorin e turizmit, Promovimin i trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Prizrenit.

Rrjeti i Organizatave Kulturore i Prizrenit është rrjet joformal i organizatave të kulturës në komunën e Prizrenit. Misioni i këtij Rrjeti është arritja e një ekonomie të zhvilluar lokale në Prizren përmes pasurimit dhe strukturimit të ofertës turistike bazuar në rritjen e cilësisë dhe vëllimit të aktiviteteve kulturore. Anëtarët e Rrjetit janë: EC Ma Ndryshe, Dokufest, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, GreenArt, X40, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshtatarëve Sharri, Leo's Art Organization dhe Xhennet Comics

Ju falemnderit për hapësirën e ofruar dhe bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,

Në emër të Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren

Hajrulla Çeku, EC Ma Ndryshe (Sekretariati i Rrok-ut)

hajrulla.cek@ecmandryshe.org & 049-116-448

Rrok Prizren – Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren

Ismet J Kumanova, Nr. 31 – 20000/Prizren

www.rrok-pz.net & info@rrok-pz.net

+381-29-222-771